



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të nenit 66 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 37, paragrafi 3.1 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publik, nenit 10 të Rregullores (KQZ) Nr. 02/2024 për pranimin e personelit të përkohshëm në KQZ, si dhe Vendimit nr.01/1779-2024 të KQZ, të datës 10.10.2024, për miratimin e grupit të tretë të pozitave për angazhimin e personelit të përkohshëm për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall:

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Grupi i teknologjisë informative
Titulli i pozitës së punës	Zyrtar për Teknologji Informative në KQZ
Arsyeja për rekrutim kontraktual	Për realizimin e një projekti
Koeficienti/Paga	5.8 / 638€ bruto
Nr. i kërkuar	1
Kohëzgjatja e emërimit	Me afat të caktuar
Data e njoftimit	30/11/2024
Afati për aplikim	01/12/2024 - 07/12/2024
Institucioni	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Departamenti	Departamenti i Teknologjisë Informative zgjedhore dhe shërbim të votuesve
Divizioni	Divizioni i Teknologjisë Informative Zgjedhore
Vendi i punës	Prishtinë
Nr. i Referencës	RN00015905
Kodi	RPC0009444



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Kujdeset për mirëmbajtjen dhe montimin e pajisjeve të teknologjisë informative përfshirë server, kompjuter, printer, fotokopje, skaner dhe pajisje tjera;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e rrjetit në aspektin e funksionimit;
- Instaloni dhe konfiguroni sistemet operative dhe aplikacionet tjera sipas nevojës;
- Ndhmon për analizimin dhe zgjidhjen e problemeve të përdoruesve të rrjetit kompjuterik;
- Ndhmon dhe mbështet stafin në përdorimin e pajisjeve dhe aplikacioneve të teknologjisë informative, dhe sipas nevojës trajnon përdoruesit në përdorimin e aplikacioneve dhe softuerëve të ndryshëm;
- Operimi me pajisjet e zërimit, përkthimit simulant dhe incizimi elektronik i mbledhjeve;
- Sigurimi dhe mirëmbajtja e tavolinës ndihmëse dhe riparimi i pjesëve harduerike;
- Sipas kërkesës jep asistencë teknike në postimin e artikujve të ndryshëm në ueb faqen e KQZ-së;
- Detyrat tjera që i caktohen nga udhëheqësi i divizionit dhe drejtori i departamentit.

## 2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LQP-së

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- **Arsimi:** Së paku shkollë e mesme dhe një trajnim në fushën e TI-së: Microsoft, IT Fundamentals, Cisco CCNA, Comptia.
- **Përvoja:** Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën e TI-së.

## 4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

---

- Njohuri të mira në fushën profesionale të TI;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe të punës në grup.



## 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

---

- Kopjen e diplomës së kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurën e nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjen e dëshmisë së punësimit (vërtetim/ kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmitë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim:
- pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, apo
- pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucionin publik (vlen për të punësuar në institucione publike);
- Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetë deklaratë me shkrim të nënshkruar, se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucionin publik.

### Dëshmitë që kërkohen në fazën e verifikimit para emërimit

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata, ose e shkarkuar nga platforma elektronike e - Kosova, përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/ e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 22/12/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 7. Kriteret specifike shtesë

---

Nuk ka.

## 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervista – maksimumi 100 pikë

## 9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 10. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

- Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësia përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve në origjinal apo të njësuara me origjinalin.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

